

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting**

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 18.01.2020

Problemi 1

Pjesa a)

Blerta shpk bleu një ndërtesë që kushton 500,000 € në 1 janar 2010 me një jetë të dobishme pesëdhjetë vjet. Ndërtesa ka një vlerë të mbetur prej 100,000 €. Në 31 dhjetor 2016, ndërtesa ishte rivlerësuar në 559,000 € sipas vlerës së tregut. Në këtë datë, nuk pati ndonjë ndryshim në jetën e dobishme të ndërtesës, por vlera e mbetur e vlerësuar ishte zero. Më 31 dhjetor 2018, ndërtesa u shit për 600,000 €.

Kërkohet:

- i) Bëni regjistrimet e duhura në kontabilitet për të regjistruar rivlerësimin më 31/12/2016
- ii) Bëni regjistrimet e duhura në kontabilitet për të regjistruar shitjen më 31/12/2018

(10 pikë)

Pjesa b)

Draft pasqyrat financiare të BESI shpk më 30 Shtator 2019 janë përgatitur, mirëpo ka mbetur një diference në vlerë prej € 6,100, e cila përkohësisht është përfshirë si *kredi* në llogarinë pezull të bilancit të gjendjes së kompanisë.

Gjatë kontrollimeve janë gjetur gabimet si në vijim:

- (1) €6,500 ishin paguar për shpenzimet e mirëmbajtjes së objekteve; në librin e arkës kjo pagesë ishte regjistruar saktë dhe ishte debituar llogaria e objekteve si pasuri në vlerë prej €5,600.
- (2) Një makinë ishte shkatërruar dhe për te ishte pranuar një çek në vlerë prej €7,000 për mbeturinat e makinës në një aksident i cili ishte regjistruar si duhet në librin e arkës mirëpo nuk ishte bërë asnjë regjistrim tjetër. Makina kishte një kosto prej €55,000 dhe zhvlerësim të akumuluar në vlerë prej €8,000. Zhvlerësimi ishte regjistruar si duhet për vitin që mbaron më 30 Shtator 2019, duke e bërë zhvlerësimin e akumuluar të makinave në atë datë €15,000. Ende asnjë regjistrim nuk ishte bërë që të eliminohet kostoja dhe zhvlerësimi i akumuluar i makinës.

Është politikë e kompanisë të mos aplikojë/ngarkojë zhvlerësim për pasuri në vitin e largimit (hedhjes).

Shënim: Pjesa a) dhe pjesa b) e detyrës janë kompani të ndryshme, andaj nuk janë të ndërlidhura.

Kërkohet:

Përgatitni regjistrimet në ditar, për të korigjuar gabimet, për të regjistruar humbjen në makinë dhe për të pastruar llogarinë pezull.

(10 pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 1

a)
$$\text{Zhvlerësimi vjetor} = \frac{500,000 - 100,000}{50 \text{ vite}} = 8,000$$

Zhvlerësimi i akumuluar = 7 vite x 8,000 = 56,000

VNL = 500,000 - 56,000 = 444,000

Vlera e tregut 559,000

Rezerva e rivlerësimit 115,000

Regjistrimet më 31/12/2016

D Ndërtesa	59,000	
D Zhvlerësimi i akumuluar	56,000	
	K Rezerva e rivlerësimit	115,000

31/12/2018

Zhvlerësimi i ri vjetor = $\frac{559,000 - 0}{43 \text{ vite}} = 13,000$

50 vite - 7 vite = 43 vite

Zhvlerësimi i akumuluar për 2017 dhe 2018 = 2 vite x 13,000 = 26,000

VNL më 31/12/2018 = 559,000 - 26,000 = 533,000

Fitimi kapital = 600,000 - 533,000 = 67,000

Regjistrimet më 31/12/2018

D: Paraja e gatshme	600,000	
D Zhvlerësimi i akumuluar	26,000	
	K Ndërtesa-Kosto	559,000
	K Fitimi kapital	67,000

Pjesa b)

1)

D: Shpenzimet e mirëmbajtjes	6,500	
K: Objektet-Pasuri		5,600
K: Llogaria pezull		900

Korrigjimi i gabimit në postimin e kostos së mirëmbajtjes të objekteve

2)

D: Llogaria pezull	7,000	
D: Humbja	40,000	
D: Zhvlerësimi i akumuluar-Makina	8,000	
	K: Makina-kosto	55,000

Llogaria Pezull

		Saldo në fillim	6,100
	<u>7,000</u>		<u>900</u>
Saldo e/b	0	Saldo në fund	0

Problemi 2

Arta ka një shitore të mobilieve në Prizren, kryesisht biznesi shet me shumicë por në raste të caktuara realizon edhe shitje në para të gatshme për qytetarë. Biznesi nuk mban regjistra të rregullt kontabël, tash përgjegjësia e biznesit është transferuara tek ju për të realizuar kërkesat të cilat ceken më poshtë. Pas një hulumtimi të hollësishëm janë përfituar informatat e mëposhtme që i përkasin vitit që përfundon më 31 Dhjetor 2019:

(i) Pasuritë dhe detyrimet më 31 Dhjetor 2018 ishin këto:		€
Ndërtesa	Kosto	500,000
	Zhvlerësimi i akumuluar	200,000
Pajisjet e zyrës	Kosto	80,000
	Zhvlerësimi i akumuluar	20,000
Stoqet		200,000
P.gatshme- arka		6,000
P.Gatshme -Banka		56,000
Llog. e arkëtueshme		24,000
Parapagimi i sigurimit		4,000
Llog.e pagueshme		56,000
Kredia (për tu paguar në 5 vite)		60,000
Akrualet e qirasë		6,000

(ii) Gjatë vitit Arta kishte faturat për shitjet të cilat më pastaj ishin deponuar në bankë. Ekstrakti bankar tregonte se 158,000 € ishin transferuar në llogari për shitjet që kishin qenë me kredi gjatë tërë vitit. Gjendja përfundimtare në arkë figuronte si 8,000 €. Arta tregoi se ai kishte tërhequr 8,000€ dhe 4,000 € nga paraja e gatshme në arkë gjatë vitit (hyrjet kesh kishin qenë nga shitjet me para të gatshme të cilat ju duhet t'i llogaritni). Llogaritë e arkëtueshme kishin saldo përfundimtare 20,000 €.

(iii) Arta ka një fitim bruto prej 25 % e shitjes, kjo vlen për të gjitha shitjet që janë realizuar gjatë vitit.

(iv) Më 31 Korrik kishte ndodhur një vjedhje e stoqeve në shitore. Duke u munduar të llogaritej se sa stoqe ishin vjedhur , Arta mund të na ofronte këto informata :

(a)Ajo e dinte se ishin paguar 44,000 € tek furnitorët për 7 muaj periudhë deri më 31 Korrik 2019.

(b)Ajo kishte Llogari të pagueshme më 31 Korrik 2019 vlerën 52,000 €.

(c) Ajo bëri numërimin e stoqeve një dite pas vjedhjes dhe kishte në depo stoqe edhe 56.000€.

(v) Në 31 tetor, Arta është dashur të heqë 6,000 € vlerë të inventarit për shkak të dëmtimit të ujit. Kompania e sigurimit ka konfirmuar se do të mbulohen humbjet në mënyrë të plotë për stoqet (mobiliat) e dëmtuara

(vi) Blerjet për tërë vitin kishin vlerë 128,500€.

Shënim- Gjatë llogaritjes së stoqeve të vjedhura konsiderojeni se shitjet janë realizuar në mënyrë proporcionale përgjatë muajve.

Kërkesat:

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

- (a) Llogarit vlerën e kapitalit në fillim duke përgatitur një Pasqyrë të Pozitës Financiare (B/GJ) për fillimin e vitit. (5 Pikë)
- (b) Llogarit stoqet e vjedhura më 31 korrik, fitimin bruto të vitit 2019 dhe stoqet në fund më 31.12.2019. (15 Pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 2

a) Pasqyra e Pozitës Financiare e Arta më 1 janar 2019

	€	€	€
Pasuritë jo-qarkulluese			
Ndërtesa dhe pajisjet	360,000	(500,000 - 200,000 + 80,000 - 20,000)	
Total Pasuritë jo-qark		360,000	
Pasuritë qarkulluese			
Stoqet	200,000		
Llog e Arkëtueshme	24,000		
Paratë në arkë dhe bankë	62,000		
Parapagimet	4,000		
Total pas. qarkulluese		290,000	
Total Pasuritë			650,000
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapital - Shifer balancuese	528,000		
Total Kapitali dhe rezervat		528,000	
Detyrimet jo-qarkulluese			
Kredia	60,000		
Total det. Jo-qarkulluese		60,000	
Detyrimet qarkulluese			
Llogarite e pagueshme	56,000		
Akrualet	6,000		
Total detyrimet qarkulluese		62,000	
Total detyrimet		122,000	
Total Ekuiteti + Detyrimet			650,000

$$P = E + D$$

$$650,000 = E + 122,000$$

$$650,000 - 122,000 = E$$

$$E = 528,000$$

b) Llogaria e arkëtueshme			
Saldo fillestare	24,000	P.Gatshme	158,000
Shitjet -shifer balancuese	154,000		

Saldo përfundimtare 20,000

Paraja e gatshme - Arka

Saldo fillestare	6,000	Tërheqjet	12,000
<u>Shitjet me P.G-shifer balancuese</u>	<u>14,000</u>		
Saldo përfundimtare	8,000		

Shitjet

Shitjet me kredi	154,000
<u>Shitjet në para</u>	<u>14,000</u>
Total shitjet	168,000

Llogaritja e KMSH

Fitimi bruto 25% në shitje

LLogaritja

Shitjet	100%	168,000
- KMSH	75%	<u>(126,000)</u>
Fitimi Bruto	25%	42,000

KMSH është 75% e shitjeve sikurse $75\% \times €168,000$ 126,000

Llogaritja e stoqeve të vjedhura më 31 korrik

Total Shitjet	168,000
Shitjet për 7 Muaj ose $€168,000 \times 7 / 12$	98,000
KMSH 75% e shitjeve. $€98,000 \times 75\%$	73,500
Stoqet në fillim	200,000
+Blerjet - shiko LLog. E pagueshme më poshtë deri me 31 korrik	40,000
-Stoqet në fund(31 korrik) -shifer balancuese	166,500
= KMSH	73,500

Stoqet totale me 31 korrik: **166,500**
Stoqet nga numërimi nje dite pas
vjedhjes: 56,000

$166,500 - 56,000 = 110,500$ - **vlera e stoqeve
te vjedhura**

		Llogaritë e pagueshme	
P.Gatshme	44,000	Saldo fillestare	56,000
		Blerjet-shifër balancuese (deri më 31 korrik)	40,000
		Saldo përfundimtare -31 korrik	52,000

Llogaritja e stoqeve në fund të vitit më 31/12/2019:

St. Fillim+ Blerjet - stoqet e vjedhura-stoqet e dëmtuara- stoqet në fund=KMSH

$200,000 + 128,500 - 110,500 - 6,000$ - stoqet në fund = 126,000

Stoqet në fund = 86,000

Problemi 3

Petriti shpk ka blerë 85% të aksioneve të Suzana shpk më 1 Janar 2019 kur fitimet e mbajtura të Suzana shpk ishin €12,000. Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes ishte €11,000. Përgjatë vitit deri më 31 dhjetor 2019, Suzana i shiti mallra Petritit për €20,000 me një marzhë mbi kosto prej 25%.

50% e këtyre mallrave ishin akoma të pa shitura nga Petriti në fund të vitit. Në të njejtën datë, Petriti shpk i pati borxh Suzana shpk €8,000 për mallrat e blera dhe ky borxh është i përfshirë në llogaritë e pagueshme tregtare të Petriti shpk dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare të Suzana shpk.

Pasqyrat e pozitës financiare të secilës kompani më 31 dhjetor 2019 janë paraqitur në vijim:

	<i>Petriti shpk</i>		<i>Suzana shpk</i>	
	€	€	€	€
<i>Pasuritë</i>				
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>				
Pasuritë e prekshme	80,000			40,000
Investimet në Suzana shpk sipas kostos	<u>46,000</u>			
		126,000		
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	30,000		25,000	
Stoqet	<u>10,000</u>		<u>5,000</u>	
		40,000		30,000
<i>Totali i pasurisë</i>		<u>166,000</u>		<u>70,000</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>				
<i>Ekuiteti</i>				
Aksione të zakonshme nga €1 secila	100,000		30,000	
Fitimet e mbajtura	<u>45,000</u>		<u>22,000</u>	
		145,000		52,000
<i>Detyrimet afatshkurta</i>				
Llogaritë e pagueshme tregtare		21,000		18,000
<i>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</i>		<u>166,000</u>		<u>70,000</u>

Kërkohet

Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare të konsoliduar për Petriti shpk më 31/12/2019.

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 3

Petriti shpk

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE E KONSOLIDUAR MË 31 DHJETOR 2019

	€	€
<i>Pasuritë</i>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Pasuritë e prekshme (80,000 + 40,000)		120,000
Zëri i mirë (L11)		15,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare (30,000 + 25,000 - 8,000)	47,000	
Stoqet (10,000 + 5,000 - 2,000 (L12))	<u>13,000</u>	
		<u>60,000</u>
<i>Totali i pasurisë</i>		<u>195,000</u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë</i>		
Aksione të zakonshme nga €1 secila	100,000	
Fitimet e mbajtura (L13)	<u>51,800</u>	
	151,800	
IJK (L14)		<u>12,200</u>
		164,000
Detyrimet afatshkurta (21,000 + 18,000 - 8,000)		<u>31,000</u>
<i>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</i>		<u>195,000</u>
<i>Llogaritjet</i>		
1	<i>Zëri i mirë</i>	
		€
	Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar	€ 46,000
	Plus vlera e drejtë e IJK-së në blerje	11,000
	Minus vlera e drejtë në blerje e pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve të pranuar:	
	Kapitali aksionar	30,000
	Fitimet e mbajtura në blerje	12,000
		(42,000)
	Zëri i mirë	15,000
2	<i>Provizioni për fitimin e varealizuar</i>	
		€
	Çmimi i shitjes	125% 20,000
	Çmimi i kostos	<u>100% (16,000)</u>
	Fitimi bruto	<u>25% 4,000</u>
	Fitimi i parealizuar (4,000 × 50%) i kompanisë Suzana shpk	2,000

3	<i>Fitimet e mbajtura</i>	<i>Petriti</i>	<i>Suzana</i>
		€	€
	Sipas pyetjes	45,000	22,000
	Fitimet e mbajtura para blerjes		(12,000)
	Korrigjimet e fitimit të pa realizuar		<u>(2,000)</u>
			<u>8,000</u>
	Fitimi që i takon grupit (85% × 8,000)	<u>6,800</u>	
	Fitimet e mbajtura të grupit	<u>51,800</u>	
4	<i>IJK në datën e raportimit</i>		€
	Vlera e drejtë e IJK-së në blerje		11,000
	Plus pjesa IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes		
	<u>(15% × 8,000)</u>		<u>1,200</u>
	IJK në datën e raportimit		<u>12,200</u>

Problemi 4

Kushtrimi sh.p.k. merret me prodhimin e produkteve plastike dhe pasqyrat financiare të tij janë si më poshtë:

Kushtrimi sh.p.k. Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2018

	2018 €'000	2017 €'000
Pasuritë jo qarkulluese		
Prona, Pajisjet dhe Impiantet	86,300	74,600
Pasuritë e patrupëzuara	<u>4,560</u>	<u>1,200</u>
Gjithsej pasuritë jo qarkulluese	<u>90,860</u>	<u>75,800</u>
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	14,320	11,300
Llogaritë e arkëtueshme	2,170	1,200
Paraja në dorë & ekuivalentët e saj	<u>8,900</u>	<u>9,200</u>
Gjithsej pasuritë qarkulluese	<u>25,390</u>	<u>21,700</u>
Gjithsej pasuritë	<u>116,250</u>	<u>97,500</u>
Kapitali & Detyrimet		
Kapitali		
Kapitali aksionar	50,000	40,000
Premia në aksione	8,000	5,000
Fitimet e mbajtura	26,220	23,590
Rezervat e rivlerësimit	<u>2,800</u>	<u>800</u>
Gjithsej Kapitali	<u>87,020</u>	<u>69,390</u>
Detyrimet afatgjata		
Kredi afatgjatë	<u>20,000</u>	<u>18,000</u>
Gjithsej detyrimet afatgjata	<u>20,000</u>	<u>18,000</u>
Detyrimet afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme	7,730	8,910
Tatimi i pagushëm	<u>1,500</u>	<u>1,200</u>
Gjithsej detyrimet afatshkurta	<u>9,230</u>	<u>10,110</u>
Gjithsej Kapitali & Detyrimet	<u>116,250</u>	<u>97,500</u>

Kushtrimi sh.p.k. Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018

Të hyrat	26,200
Kosto e mallit të shitur	<u>20,200</u>
Fitimi Bruto	6,000
Shpenzimet administrative	1,100
Shpenzimet e shpërndarjes	1,600
Shpenzimet e interesit	<u>200</u>
Fitimi/(humbja) para tatimit	3,100
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>380</u>
Fitimi/(humbja) për vitin	2,720

Shënime:

- (i) Kushtrimi sh.p.k. shiti një pronë me një vlerë neto në libra prej €1,400,000 për €1,500,000 gjatë vitit financiar që përfundon më 31 dhjetor 2018. Zhvlerësimi vjetor për të njëjtin vit financiar ishte €320,000.
- (ii) Kushtrimi sh.p.k. ka paguar dividendë në vlerën €90,000 në vitin 2018.

KËRKOHET:

Përgatitni një Pasqyrë të rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 për Kushtrimi sh.p.k., në përputhje me SNK 7 - *Pasqyra e rrjedhjes së parasë.*

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

(a) **Kushtrimi sh.p.k. Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018**

Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative	€'000	€'000
Fitimi para tatimit	3,100	
Rregullimet për Zhvlerësimin	320	
Fitimin nga shitja e PIP	(100)	
Shpenzimet e interesit	200	
	3,520	
Rritja në stoqe	(3,020)	
Rritja në llogaritë e arkëtueshme	(970)	
<u>Zvogëlimi në llogaritë e pagueshme</u>	<u>(1,180)</u>	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	(1,650)	
Interesi i paguar	(200)	
Tatimi në fitim i paguar	(80)	
Paraja neto nga aktivitetet operative		(1,930)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesa për blerjen e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve	(11,420)	
Pagesa për blerjen e pasurisë së patrupëzuar	(3,360)	
Pranimi nga shitja e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve	1,500	
Paraja neto nga aktivitet investuese		(13,280)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		
Të ardhurat nga emetimi i aksioneve (10,000+3,000)	13,000	
Pagesa e dividendëve	(90)	
Marrja e kredisë afatgjatë	2,000	
Paraja neto nga aktivitet financuese		14,910
Rënia neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj gjatë vitit		(300)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	Shënimi 1	9,200
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	Shënimi 1	8,900
Shënimi 1	2018	2017
	€'000	€'000
Paraja në dorë dhe në bankë	8,900	9,200
Mbitërheqja bankare	-	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj	8,900	9,200

GJITHSEJ PIKË

20

Fitimi nga shitja e PIP	€'000
VNL në datën e shitjes	1,400
Të ardhurat nga shitja	1,500
Fitimi në shitjen e PIP	100

Tatimi i pagueshëm

Tatimi në fitim i paguar (Shifer balancuese)	80	Saldo në fillim	1,200
Saldo në fund	1,500	Shpenzimet e tatimit në PA	380
	<u>1,580</u>		<u>1,580</u>

Llogaria e Pronës, Pajisjeve dhe Impianteve (VNL)

Saldo në fillim	74,600	Shpenzimet e zhvlerësimit	320
Rivlerësimi	2,000	Pasuria e shitur - VNL	1,400
Blerja e PIP (Shifer balancuese)	11,420	Saldo në fund	86,300
	<u>88,020</u>		<u>88,020</u>

Problemi 5

Llogaria bankare e Kaoni sh.p.k. për muajin dhjetor 2019 ishte si vijon:

D.		Libri i arkës Kaoni sh.p.k.				K.	
Data	Pranimet	€	Data	Pagesat	Nr. i çekut.	€	
09/12/19	Luani	12,475	01/12/19	Saldo hyrëse		2,682	
18/12/19	Cana	2,451	02/12/19	Leon	8215	451	
23/12/19	Doni	4,125	04/12/19	Herta	8216	1,425	
28/12/19	Keana	6,581	06/12/19	Noar	8217	326	
30/12/19	Transfer kreditor	2,314	10/12/19	Qiraja	D.D.	1,000	
			14/12/19	Murati	8218	214	
			19/12/19	Tarifa bankare	D.D.	26	
			20/12/19	Niti	8219	124	
			23/12/19	Henori	8220	541	
			27/12/19	Fuadi	8221	1,482	
			30/12/19	Limani	8222	2,481	
			31/12/19	Saldo mbyllëse		17,194	
		<u>27,946</u>				<u>27,946</u>	
		<u><u>17,194</u></u>				<u><u>17,194</u></u>	
01/01/20	Saldo hyrëse	17,194					

Ekstrakti bankar i Kaoni sh.p.k. dhjetor 2019

Data	Përshkrimi	Pagesat €	Depozita €	Saldo €
01/12/19	Saldo			-2,182
01/12/19	Çek	8213	300	-2,482
01/12/19	Çek	8214	200	-2,682
06/12/19	Çek	8215	415	-3,097
08/12/19	Çek	8216	1,425	-4,522
10/12/19	Depozitë		12,475	7,953
11/12/19	Qiraja		1,000	6,953
15/12/19	Çek	8218	214	6,739
16/12/19	TV		82	6,657
19/12/19	Tarifa bankare		26	6,631
20/12/19	Transfer kreditor		2,451	9,082
24/12/19	Depozitë		4,152	13,234
26/12/19	Çek	8220	541	12,693
27/12/19	41574		632	12,061
29/12/19	Depozitë		6,581	18,642
30/12/19	Çek	8221	1,482	17,160
31/12/19	Telefoni		124	17,036
31/12/19	Sigurimi		540	16,496
31/12/19	Transfer kreditor		1,411	17,907

Banka ka konfirmuar për Kaoni sh.p.k. që ka bërë një gabim regjistrimi në llogarinë e tij bankare më 27 dhjetor 2019 në shumën €632.

KËRKOHET:

Përgatitni një pasqyrë bankare të harmonizuar për Kaoni sh.p.k. për muajin që përfundon më 31 dhjetor 2019.

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

Hapi 1: Harmonizoni saldon në fillim të librit të arkës me ekstraktin bankar

Saldo në fillim të muajit në librin e arkës - 01/12/2019 (2,682)

Saldo në fillim sipas ekstraktit bankar - 01/12/2019 (2,182)

Minus çeqet e datës 1/12

Çeku	8213	(300)
Çeku	8214	(200)
		<u>(2,682)</u>

Libri i arkës-Korrigjimet

Dhjetor	€	Dhjetor	€
31 Saldo	17,194	16 TV	82
31 Çeku 8215 - gabimet e arkës -Diferenca	36	31 Telefoni	124
31 Transferi kreditor	1,411	31 Sigurimi	540
31 Gabimi i arkës (23/12/19) - Diferenca	27		
		Saldo në fund	
		31 e korrigjuar	17,922
	<u>18,668</u>		<u>18,668</u>

Harmonizimi i ekstraktit bankar

Saldo në fund sipas bankës		
Ekstrakti - 31/12/2019		17,907
Minus çeqet e pa paraqitura		
Çeku 8217	326	
Çeku 8219	124	
Çeku 8222	2,481	(2,931)
Shto depozitimet ende të pa regjistruara		
Depozitimet në tranzit 30/12/2019	2,314	2,314
Gabimet bankare		
41574 - 27/12/2019	632	632
Saldo e korrigjuar sipas ekstraktit bankar		<u><u>17,922</u></u>